



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 23.

Prishtinë, më 23.06.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Ilir Deda, Arben Gashi, Time Kadrijaj, Luljeta Veselaj - Gutaj, Kujtim Paçaku dhe Sllobodan Petroviq.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Vjosa Osmani.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Florent Mehmeti.

Në mbledhje mori pjesë mbledhje mori pjesë ekspert slloven i angazhuar nga GIZ-i, z. Primozh Vehar.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky :

R E N D I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 21.5.2015 dhe 27.5.2015;**
- 3. Takimi me z. Primozh Vehar, ekspert nga Sllovenia;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e nisi mbledhjen sipas rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua.

- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 21.5.2015 dhe 27.5.2015;**

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 21.5.2015 dhe 27.5.2015 u miratuan pa vërejtje.

3. Takimi me z. Primozh Vehar, ekspert nga Sllovenia;

Kryetarja falënderoi z. Primozh Vehar për gatishmërinë për ndarjen e eksperiencës së shtetit të tij, lidhur me proceset që vendi ynë është duke i kaluar.

Falënderoj GIZ-in për organizimin e këtyre takimeve për përafrimin e legjislacionit në kuadër të Kuvendit të Kosovës, në procesin e integritimeve evropiane, tha ajo dhe ia dha fjalën z. Vehar që në cilësinë e ekspertit dhe duke u bazuar në përvojën e Sllovenisë, të marrim sa më tepër informata rreth procesit të integritimeve evropiane.

Primozh Vehar tha se përveç përafrimit ligjor, Komisioni për Integritime Evropiane ka edhe detyra tjera në procesin e integritimit evropian. Së pari të sigurojë kontrollin mbi Qeverinë, duke shtruar pyetje për të mbështetur Qeverinë në progresin e procesit të integritimeve, bashkëpunimi me parlamentet tjera, veçanërisht me shtetet e BE-së, me komisionet homologe sepse është obligim nga MSA-ja, e cila bëhet përmes procesit të harmonizimit të legjislacionit, shqyrtimit parlamentar mbi procesin e negociatave dhe informimin e qytetarëve lidhur me BE-në.

Në vazhdim ai përgëzoi për MSA-në, e cila do të vendosë marrëdhëniet e para kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

MSA-ja siç e dini, i ka disa pjesë. Pjesa e parë mjaft e rëndësishme është pjesa ekonomike ku vihen themelet e raporteve të tregtisë së lirë me shtetet anëtare të BE-së dhe Kosovës.

Pjesa e dytë e MSA-ja është politikë, që ka të bëjë me themelimin e kontakteve direkte në mes të Kosovës në njërin anë dhe institucioneve të BE-së, në anën tjetër. Qeveria e Kosovës në këtë pjesë do ta ketë rolin kryesor sepse është përgjegjëse për implementimin e asistencës evropiane. Vendim marrja politike i takon Këshillit të Asocimit dhe stabilizimit në të cilat rolin kryesor e luajnë Qeveria dhe ministrat e saj si dhe zyrtarët e lartë të BE-së.

Këshilli i stabilizimit dhe asocimit në kryerjen e detyrave të veta ndihmohet nga një Komision i stabilizimit asocimit i përbërë nga përfaqësues të BE-së dhe Qeverisë dhe duhet të takohet një herë ose dy herë në vit dhe duhet të miratojë vendimet kryesore politike lidhur me zbatimin e MSA-së, krijon nën-komisione që trajtojnë të gjitha çështjet politike, teknike dhe ekzekutive. Detyra e Parlamentit këtu është të kërkojë nga Qeveria të informohet se cilat janë çështjet e hapura dhe Komisioni për Integritime Evropiane duhet të kërkojë informata nga takimet se si kanë shkuar takimet dhe cili është progresi.

Roli i Parlamentit në MSA është Komisioni i përbashkët Parlamentar, i cili themelohet pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Ky është një forum për anëtarët e Kuvendit dhe Parlamentit Evropian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet. Ai përcakton rregulloren e vet të punës dhe kryesohet me rotacion nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi, takohen dy herë në vit për të diskutuar për problemet, progresin dhe hapat e ardhshëm që duhet të ndermiren.

MSA-ja ka kaptina të rëndësishme, ku flasin për përafrimin ligjor, Kosova gradualisht do ta miratojë legjislacionin i cili do të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me hyrjen në fuqi të MSA-së, përafrimi ligjor do të jetë obligim ndërkombëtar.

Roli i Parlamentit nuk është vetëm për të miratuar ligje por për të shqyrtuar procesin e përgjithshëm të përafrimit të ligjeve, që nga vendosja e prioriteteve e deri te zbatimi i besueshëm.

Qeveria është e obliguar në përkthimin e Acquis në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe ju duhet të bëni presion Qeverisë në gjetjen e mënyrave për të siguruar përkthimet edhe nga shtetet fqinje, si Serbia dhe Shqipëria për të mos përkthyer atë çka është përkthyer, sepse përkthimi është shumë i shtrenjtë, në Slloveni ka kushtuar 200 milionë euro dhe BE-ja nuk ka financuar për asnjë pjesë të përkthimeve. Komisioni për Integritime Evropiane duhet nga Qeveria të informohet lidhur me at si po shkon përkthimi dhe a ka ndonjë bashkëpunim me BE-në dhe bashkëpunim me ndonjë shtet fqinjë. Pas organizimit të përkthimit dhe përafrimit

ligjor vjen draftimi i ligjeve dhe pastaj miratimi i tyre në Parlament, ku Komisioni për Integritet ka një rol të madh me pyetje të hapura se çka do të sjellin për Kosovën, çka është mirë dhe çka jo për Kosovë dhe cilat janë impaktet.

Në Slloveni Komisioni për Integritet Evropiane disa herë ka ftuar odat ekonomike në komision për të diskutuar për disa ligje të rëndësishme dhe disa herë i ka propozuar amendamente komisionit për ekonomi. Ne në fillim kishim probleme me tabelat e përputhshmërisë sepse kanë qenë në gjuhën angleze..

Tabelat e pajtueshmërisë bëhen për 3 arsye. Obligon përpiluesit e ligjit të përfshijnë direktivat në Projektligj dhe është për Qeverinë dhe Parlamentin për të parë çka është përfshirë dhe çka jo dhe për Komisionin për Integritet Evropiane, a i ka përmbush obligimet apo jo.

Në MSA, në kaptinën e përafrimit thuhet se Kosova duhet ta përgatis programin ligjor për 3 vite dhe duhet t'i plotësojë 3 kritere: politike, ekonomike dhe atë të përafrimit ligjor. Qeveria duhet ta bëjë programin, e kjo duhet bërë këtë vit dhe 2 vitet e ardhshme. Ky dokument është mjaftë i rëndësishëm dhe Qeveria ka qindra ekspertë të fushave të ndryshme, kurse Parlamenti nuk ka ekspertë të të gjitha fushave, por duhet ta ketë rolin e mbikëqyrjes së Qeverisë, Planit të veprimit, për t'i shqyrtuar ligjet dhe kontrollimin e tabelave të pajtueshmërisë nga ana e stafit. Çështjet evropiane dhe përafrimi ligjor nuk janë detyrë vetëm e Komisionit për Integritet Evropiane por edhe e komisioneve dhe drejtorive të tjera, të cilat duhet të përfshihen në këtë proces.

Kryetarja falënderoi z.Primozh Vehar për prezantimin e përvojave në procesin e integriteteve në shtetin tij. Ajo theksoi se pas nënshkrimit të MSA-së, Kosova po shkon në një fazë të re dhe ne kemi nevojë për bashkëpunim më të thellë, në mënyrë që këtë fazë ta kalojmë sa më lehtë dhe të mësojmë nga të arriturat dhe gabimet e shtetit tuaj që kjo rrugë të jetë më e lehtë.

Roli i Komisionit për Integritet Evropiane do të ketë rol shumë ma aktiv pas nënshkrimit të MSA-së dhe është koha e duhur të përgatitemi për aktivitete shumë më të mëdha që do t'i bëjmë.

Javën e kaluar kemi shqyrtuar Projektligjin për Kuvendin në kapitullin që ka të bëjë me integritet evropiane dhe rolin e komisionit për integritet në parlamentin e Kosovës, në raport me Qeverinë lidhur me integritet evropiane, ne kemi kërkuar që komisioni ynë të ketë një rol më aktiv dhe kemi kërkuar që për vendime të ndryshme, Qeveria para se të shkojë në Institucionet evropiane të vjen në Komision dhe paraprakisht ta merr mandatin negociues. Lidhur me këtë pyeti z. Vehar se si është e rregulluar kjo në Parlamentin Slloven dhe cili është roli i Komisionit për vendimet të cilat i merr Qeveria, a konsultohet komisioni.

Në vazhdim lidhur me komisionin e përbashkët parlamentar, Sahaqija tha se ne kemi propozuar që nga Kuvendi të jetë i përfshirë i tërë Komisioni për integritet dhe duke pas parasysh që raporti me institucionet evropiane do të përfshijë edhe çështje ekonomike, shëndetësore, arsimin e të tjera, kemi kërkuar që të përfshihen edhe 4 kryetarët e komisioneve që prekin këto fusha dhe pyeti se si është struktura e këtij Komisioni në Parlamentin Slloven dhe sa anëtarë janë.

Ilir Deda në komentimin e tij tha se dokumenti i MSA-së me iniciale Kosovë dhe BE, do të pësojë ndryshime dhe për këtë na kanë informuar zyrtarët e Komisionit Evropian në Bruksel, dhe kjo është hera e parë që një dokument i cili merr inicialet ndryshon njëanshëm prej anës së BE-së dhe Kosova nuk do të ketë të drejtë që të fus diçka tjetër. Kjo ka të bëjë sepse BE-ja nuk ka harmonizim mes vete çka do të thotë marrëveshja evropiane dhe nuk do të ketë nënshkrim tash por në vjeshtë, kështu na është thënë zyrtarisht.

Si deputet jam i shokuar si mundet me u ndërrua një dokument njëanshëm dhe nuk është korrekte kjo qasje ndaj Kosovës.

Ne si Komision për Integritet Evropian, në Ligjin për Kuvendin kemi vendosur të marrim praktikën e Danimarkës, ku ne do t'ia japim mandatin negociues zyrtarëve të Qeverisë për çështje të prioritetit të lartë, në negociata me BE-në, pasi të hyjë në fuqi MSA-ja. Plani kombëtar për Acquis është duke u punuar nga Qeveria dhe ne po e presim prezantimin e tij në shtator, pasi do të vijë edhe nënshkrimi zyrtar i MSA-së. Gjithashtu tha në vazhdim Deda, është diskutuar që të rritet numri i stafit i shërbyesve civilë, pasi të hyjë në fuqi MSA-ja, pra sa na i përket neve, jë pjese të punës e kemi bërë, ndërsa sa i përket pjesëve tjera do t'i diskutojmë në shtator. Është mirë që në rekomandimet tuaja, janë identifikuar mangësitë e Kuvendit.

Primozh Vehar- Raporti im me rekomandime fokusohet në çështjet e përafrimit ligjor dhe kam tentuar që t'ju ofrojë solucione pozitive. MSA-ja hyn në një fazë të re dhe Kuvendi është më i ekspozuar. Kur flasim për gabimet që i ka bërë Sllovenia gjatë këtij procesi, lidhet me themelimin e Komisionit të përbashkët me Komisionin Evropian se ne kemi insistuar që anëtarët të jenë vetëm të Komisionit Evropian dhe kanë qenë të përfshirë njerëzit që nuk e dinin gjuhën angleze, andaj mos e bëni gabimin e njëjtë, pra zgjidhja më e mirë për ju është që të përfshihen edhe kryetarët e komisioneve tjera.

Stafi i komisionit për integritet e ka mbështetur Komisionin e përbashkët parlamentar dhe ne kemi pas departamentin për integritet evropian, i cili e ka mbështetur edhe Komisionin për Integritet dhe Komisionin e përbashkët parlamentar.

Koordinatori i komisionit për integritet ka qenë i njëjti për të dy komisionet. Në fillim Komisioni i përbashkët takohej një herë në vit e pastaj dy herë në vit. Kryetari i komisionit për Integritet Evropian dhe koordinatori i komisionit kanë rol të rëndësishëm në këtë proces, sepse koordinatori i komisionit duhet të koordinohet me koordinatorët nga ana e BE-së. Qëllimi është progresi në BE, Qeveria dhe Parlamenti janë të pavarura, por Qeveria është përgjegjëse për të punuar në politikën e Integritetit evropian dhe t'i përgjigjet parlamentit dhe parlamenti është i pavarur ta miratojë legjislacionin, ta miratojë buxhetin, por nuk ndërhyjnë në çështjet strikte të Qeverisë.

Qeveria duhet t'ju përgjigjet juve për çdo marrëveshje ndërkombëtare dhe e drejta e juaj është të parashtroni pyetje dhe të merrni përgjigje për të gjitha çështjet.

Programi për përafrimin ligjor dhe prioritetet propozohet nga Qeveria dhe pastaj ju përcillet juve, pastaj detyra e juaj është të bëni pyetje për çështje të caktuara. Para se të shkojnë ministrat në Bruksel, ata duhet të vijnë në Komision për Integritet dhe ju duhet të vendosni njoftoheni se si kanë shkruar bisedimet dhe pas publikimit të raportit të progresit në tetor, ju duheni ta ftoni Qeverinë për ta diskutuar raportin.

Kryetarja tha se në gjatë shqyrtimit të Ligjit për Kuvendin, diskutuam lidhur me marrjen e mandatit negociues të ministrave para se të shkojnë në Bruksel, andaj pyeti z. Primozh Vehar se si është vendosur në Parlamentin e tyre për këtë çështje, a ka pas parlamenti kompetencë miratimit apo mosmiratimit e qëndrimeve të ndryshme të Qeverisë.

Primozh Vehar tha se sa i përket negociatave për anëtarësim në BE, ne kemi pas rregulla shumë më strikte se shumë shtete në atë kohë. Ne nuk kemi pas ligj për parlamentin, negociatat për hyrje në BE, ne i kemi bërë me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjatë negociatave për anëtarësim, ju keni 3 opsione, të mos bëni asgjë të ja leni Qeverisë të merret dhe në fund t'i ratifikoni traktatet, këtë opsion nuk ua kisha preferuar.

Opsioni i dytë është të kërkonin nga Qeveria të raportohet për çdo gjë dhe ju ta jepni miratimin dhe opsioni i fundit është të ju njoftojë se çka po ndodhë.

Qeveria në Slloveni duhej t'i propozonte të gjitha pozicionet negociuese, duke u mbështetur në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe i paraqiste në Komisionin për punë të jashtme. Sesionet ishin të mbyllura dhe ishte mirë për Qeverinë sepse ndahej përgjegjësia me Parlamentin.

Kryetarja Teuta Sahatqija në fund falënderoi z.Primozh Vehar për shpjegimet dhe ndarjen e eksperiencave me Komisionin për Integritet Evropian.

4. Të ndryshme.

Për këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

E përgatiti :

Njësia për mbështetje të komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Znj. Teuta Sahatqija